



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Praturot - Primbjeno Me Datan: 15-01-2025			
Nr. i Org. Unit Org. Bro.	Nr. i Punës Pun. Bro.	Subjekt i Praturot	Vlera Vrednost
01-	060	01-	27



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e I të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **22.01.2025 (e Mërkure)**, në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Konferencave në objektin e vjetër të komunës së Vitisë.  
Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dymbëdhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2025.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin-ndryshimin e vendimit Nr. 01-035/02-1356, të datës 29.11.2024, për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshimin-plotësimin e vendimit paraprak me nr. 01-035/02-1358 të datës 29.11.2024 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit
5. Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2024.
6. Informatë mbi punën e komitetit për komunitete të komunës së Vitisë për periudhën Janar - Dhjetor 2024.
7. Informatë për zbatimin e planit të KKS-së për vitin 2024.

Viti, më 15.01.2025

Me respekt!  
Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E DYMBËDHJETË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **17.12.2024 (e ejte)**, në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, z.Jakup Demiri, znj.Majlinda Shabani, znj.Zyrafete Rama, znj.Zejnepe Osmani. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se ka anëtarë për kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e dymbëdhjetë të rregullt të KPF-së për këtë vit! Në kuadër të kësaj periudhe ligjshmëritë që na kanë ardh janë të vlefshme, nuk kemi asnjë kontestues nuk e di a ka ndonjë që nuk na është kthyer. Pra, materialin e keni marrë me kohë, para se me hy në rend të ditës hapim diskutim.

**z.Ramadan Deliu:** Unë e kam një pyetje për te Kadastrin. Për me qitë një pronë mbi vete po deshke me shku me marrë një letër, mandej me ardh këtu në komunë me marrë një fakturë, tani me shku prapë atje me pagu. Kur kesh dje, ishin kanë disa të Ferizajt dhe ata kanë probleme, nuk e dinë vendin parkingin. Për me lehtësu këtë punë duhet të behet si më herët, jo me bë këtë maltretim.

**znj.Majlinda Osterglava, drejtoreshë:** Këto nuk janë vendime që i planifikon Drejtoria e Kadastrit. Ka qenë më herët atje, tash i kam parë që janë anku, por drejtoresha e financave duhet me ta dhënë këtë përgjigje më mirë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Është pak problematikë kryesues, për shkak se ai rektorat si e kemi spjegju nuk e ka mbulu në tërësi si vend i punës dhe tani e kanë bart për momentin arkatarin këtu, dhe arkatari nuk lejohet me dalë jashtë objektit. Ndoshta në të ardhmen duhet ta shikojmë mundësinë ai që ka punë më pak me ngarku dhe me atë, por gjendja për momentin është kështu. Së bashku me Ibadetin, Qëndrimin kemi përgatit informatën për KKSBB, por planin e punës kisha thanë me fut sot në rend të ditës, pasi ishin vetëm 4 pika, sepse janari është pak më i ngarkum. Në rastë se me lejoni, me lejen e juve, ta lëshoj për kuvend si plan i punës për 2025, mandej informata shkon për janar.

**z.Jakup Demiri:** Te puna e sheshit: a do të përfundoj këto ditë si është çështja, dhe te kjo rruga me kubza a është bërë pranimi teknik dhe kur kryhet, se ka ankesa prej banorëve sidomos natën zhurma shumë dëgjohet.

**z.Illir Zuka:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kam një shqetësim në Pozheran. E dimë që për 2 vite na është thyer 17 herë fusha sa kam qenë unë përgjegjës i klubit, tani jam në pushim, por para disa ditëve ka ndodh një vandalizëm i pa parë në fushën ndihmëse të "Lagjja e Muhaxherëve". Unë e di që nuk është përgjegjësi e juaja për me gjetë, por është për me mbrojt pronën e juaj. Aty është bërë një demolim i zhuveshtoreve. Për fat të keq ka kalu dhe te shtyllat dhe tek ulset e bankës rezervë. Kisha kërku prej nënkryetarit me marrë masa me vendos kamera apo diçka. Ne jemi mundu me ruajt, ata e kanë dëmtu natën, ne e kemi rregullu ditën. Gjendja që ish tash është gjynah. Pata dhe një takim me komandatin e stacionit policor që është në Pozheran, ai shprehke

keqardhje dhe kemi me provu me i gjetë. Unë i thashë problemi më i madhë është se ne i gjetëm, por nuk u ndërmurr asgjë ndaj tyre. Kanë qenë 5-6 vetë nën moshën 18 vjeçare. Nuk e di se çfarë qëllimi kanë ata, por një investim me vlerë afër 300 mijë euro për teke të dikujt me ardh në atë gjendje është gjynah. Problemi më i madh që është tek ne, se ne po bajmë punë, po veq për shkak të mirëmbajtjes ata po prishen.

**znj.Majlinda Shabani:** Ne patëm kërku një listë të rrugëve dhe punimeve që janë bërë me pranim teknik kur ka me na ardh ajo listë, dhe tjetra është një rrugë “Muhamet Mehmeti” në Viti, është një dyqan i madh gjithçka 1 euro, është një rrugë që aty ka nevojë me u asfaltu, por unë sa jam interesu ajo rrugë nuk është e pronës publike dhe këtu ka qenë problemi më herët që kemi adresu, se aty është një vajzë që është me nevoja të veçanta dhe nuk ka shtëpia aty shumë. Rruga nuk është shumë e gjatë, rruga krejt është gropa. Si janë mundësitë që mundemi me bë një zgjidhje? Nëse nuk mundemi me bë shpronësimin të paktën kishim mujtë qoftë me shtru me ndonjë zhavorr ose diçka. Unë e di që kryetari në shumë situata me disa prona private ka mujtë me bë zgjidhje, tani në këtë situatë nuk e di si mundemi, por mirë do të ishte.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** E vetmja mundësi është me ardh ata që janë në emër të tyre. Unë ja lëshoj një autorizim avokatit të komunës dhe nis procedurat te noteri, del në emër të komunës dhe kryhet.

**z.Illir Zuka:** Kam dhe një ankesë që kam marrë te kjo shkolla mbrapa Vives me orë të tëra, d.m.th çdo ditë Viva e bllokun që lidhë rrugën e shkollës, kam marrë ankesë që me bë një zgjidhje aty, sepse aty po bllokohet rruga duke e shkarku mallin.

**znj.Zyrafete Rama:** Përshendetje për të gjithë! Unë e kam një pyetje për shkollën “Halil Alidema”. Nënkyetar, a keni njohuri më të frikshme se a do të kryhet ky objekt, d.m.th me 8 janar me fillu nxanësat gjysmëvjetorin e dytë në shkollën e re.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Nënkyetar, edhe një herë ka qenë mirë me bisedu për këtë pjesën e trotuarit në Smirë. Nuk kanë dalë me intervenu dhe atëhere kur the dhe është bërë keq vende vende pa u përfundu, dhe kam një ankesë nga një plak i Skifterajt, dritat me një lagje nuk janë tu shkymë as ditë as natë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Për sheshin dje kam pas një takim, shumë i pakënaqur jam për vonesën, sepse për kualitet nuk guxoj me u përgjigjë, dhe ata mendojshin që jam kundër shkollës së Pozheranit. Unë ju thashë që ti në shkollë të Pozheranit je nënkryetar, këtu je kontraktor. Aty ku je kontraktor këtu kam punë me ty, por në shkollë të Pozheranit kurr nuk të kam thirrë se e thirri kontraktorin, megjithatë ma ka dhanë fjalën që brenda javës me u kry, por sa i beson ti 100 herë më pak i besoj unë, por presionin ka me ja bë të vazhdueshëm. Për kubza pranim teknik nuk është bërë. Për te fusha është ndoshta me u habit dhe policia me pas ndoshta një vëmendje më të theksme, por dhe si Këshill i Fshatit Pozheran ndoshta ka qenë mirë me bisedu me prindët e atyre fëmijëve, ata kanë shfrytëzu këtë situatë ku policia me shumicë janë në Mitrovicë, aty që kryhet ajo vepër nuk është asnjë përfitim vetëm një krim.

**z.Jakup Demiri:** Unë kam bisedu me një të Pozheranit, ndoshta kish qenë mirë një takim me komandatin e policisë këtu, se personat që kanë demolu ata janë të njohur për policinë, kanë bë edhe akte të tjera, por nuk janë dënu kurr, a në hallë është Pozherani nga ta.

**z.Illir Zuka:** Ne kemi kontakti edhe me prind, edhe pse kemi pas raportin e policisë, prapë kanë thanë që i jemi smundet me qenë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Majlinda, për atë listën ua përkujtoj që për kuvend me sjellë. Zyrafete, kur përfudon nuk e di, por shkolla është ka punohet me intenzitet të lartë. Tash a do të bëhet për 8 janar nuk e di atë. Më mirë është me pritë dhe 1 muaj dhe të kryhen punët mirë, po ta themë nga përvoja ime në fshatin Remnik, kryetari atëhere Nexha ka pas marrë vendim pa pranim teknik me hy nxënësat dhe ende ballafaqohemi me probleme. Ai nuk e ka marrë me qëllim të keq, por që është zgjatë puna shumë. Ne në shkollën në Remnik kemi zbulu që kurr nuk ka punu banjo prej ditës së parë, dhe kur e kanë hapë është parë që ka qenë e zant me beton dhe kësi raste mos me pas.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ato punët që mbesin pa kry, kur të hynë më nuk ka përgjegjësi. Njëjtë na ka ndodhë edhe në teknikë dhe kanë mbetë ashtu. Pasi që nuk ka më për debat, për këtë mbledhje kemi parapa këtë:

## Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2025.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për dhënien e pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.
4. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Vitisë për vitin 2024.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ka ardhë dhe një pikë e rendit të ditës. Pasi që dje kanë pas një mbledhje Komiteti për Komunitete dhe sot e kanë sjellë planin me shti dhe me kalu në këtë seancë. Nëse jeni me shti në rend të ditës propozim vendimin për aprovimin e planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025 dhe propozimin e planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025. A jeni që të miratohet rendi i ditës me këto pikat shtesë? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa**

**z.Jakup Demiri:** Në faqen 4, nëse nuk është pronë private: atëherë a mundemi ne me bë? Ligji e parashef si dojmë ne me bë si kuvend e këtu është. Ne mundemi me bë si dojmë vetëm këtu të bëhet ndryshimi.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet procesverbali me këtë ndryshim? Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025**

**Znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Siç e dini, çdo vit jemi të obligum me ligj mbi Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim që na obligon çdo vit me përgatit listën për vitin e ardhshëm, pronat të cilat janë të gatshme me i dhënë në shfrytëzim. Janë 8 zona, Njësia Kadastrale Zhiti, destinimi bujqësor, periudha kohore afatshkurt. Njësia dytë në Devajë, destinimi bujqësorë, periudha kohore afatgjate. E treta Budrikë e Epërme, destinimi zonë industriale ekonomike afatgjatë. E katërta Smirë, destinimi pyjor afatshkurt. Njësia e pestë Goshicë, destinimi shfrytëzim bujqësor afatshkurt. E gjashta, Sodovinë e Qerkezve, zonë industriale afatshkurt. E shtata është në Binçë, afatgjatë. E teta në Terpezë, zonë bujqësore afatshkurt, d.m.th këtu bazohemi pronat që janë dhanë në shfrytëzim i heqim ato që janë në procedurë, d.m.th me ligj duhet me qenë prapë deri sa të mbyllet dhe këto tjerat bazohemi në bazë të kërksave dhe pronat të cilat nuk kanë kontest gjyqësorë i parashomi këtu me qenë në listë.

**z.Ramadan Deliu:** Kjo në binçë a është pylli andej nga Debelldehu.

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Mesa e di unë është ajo pjesë.

**z.Jakup Demiri:** Te kjo pjesa në Terpezë, që është pjesa prej 300 metrave katrorë, te njësisë kadastrale, këtë se kam të kjart a është edhe kjo 13 mijë apo vetëm kjo pjesa 300 metra katror nga sipërfaqja e përgjithshme.

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Prej kësaj sipërfaqes së madhe kemi vetëm 300 metra me i dhanë në shfrytëzim. Këto nuk jan të ndamë, këto vetëm i parashohemi në rast se ka kërkesa ne nuk i japim të gjitha si sipërfaqe.

**znj.Majlinda Shabani:** Mua diçka që po më bjen në sy është te pjesa e arsyetimit dhe te periudha kohore arsyetimet gati se janë të njëjta, po unë dua ta di këtë vlerësimin në bazë të çfarë parametrave ose çfarë planifikimi kanë shpreh ata që kan dashtë me marrë pronën për me u shfrytëzu dhe që është afatshkurt dhe afatgjatë.

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Afatshkurtë është prej 1 viti deri 15 vite. Ne mundemi me pas një kërkesë për kullosa ose për serra tani në afatgjatë nuk mundesh me ja dhanë 99 vite për një serrë.

**znj.Majlinda Shabani:** Çka hynë në afatgjatë.

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Investimet që janë më të mëdha, agroturizëm për panelat solare, ato janë 15 deri 99 vite afatgjatë, kurse afatshkurt janë 1 vit deri 15 vite. Nëse hynë në afatgjatë ti mundesh mos me ja dhanë për 99 vite po ajo vetëm jepet si periudhë kohore afatgjatë. D.m.th mbi 15 vite.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kjo pika 6 pse zonë industriale.

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Urbanizmi me plan zhvillimor komunal kështu e ka parapa.

**z.Illir Zuka:** Kisha pas një propozim në Pozheran tek rruga e Sllatinës, konkretisht te “Lagjja Korrant”. Kisha dash të me qitë si zonë me interes për aryse se ka hapsirë të madhe dhe është ndoshta një ndër zonat e vetme në Pozheran që na ka mbetë. Kisha kërku me marrë masa.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Këto janë regjistër i pronave të cilat i ka potencial komuna që mund me ju dhanë të interesuarve për zhvillim të biznesit.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Shumica kanë qenë dhe vitin e kaluar. Pra, a jeni që të shkoj për kuvend? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

### **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për dhënien e pronës se komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë**

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave e kemi për obligim ligjor. D.m.th është me afat 2 vjeçar. 2 anëtarë të propozuar prej ekzekutivit dhe 3 anëtarë mbetet me u propozu në kuvend.

**z.Jakup Demiri:** Ky është komision i kuvendit komunal edhe 2 përfaqësues prej ekzekutivit një prej sektorit joqeveritar dhe 2 prej kuvendit, po i bie 50 me 50. Nëse hynë vetëm me ekzkuvin kuvendit dhe nëse e shton prej sektorit joqeveritar, atëherë përfaqësuesit e kuvendit komunal mebsin ner 50% të anëtarëve. Komisioni i kuvendit komunal duhet ti ketë mbi 51% të anëtarëve të vetë.

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Te Ligji mbi Dhënien në Shfrytëzim, neni 18, kryetari i komunës poropozon 2 anëtarë nga egzekutivi i komunës, kuvendi i komunës propozon 2 anëtarë nga kuvendi i komunës nga radhët e subjekteve të ndryshme politike dhe 1 anëtar nga sektori joqeveritar, i cili propozohet nga sektori joqeveritar lokal.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe kjo pikë.

Si pikë e katërt e rendit të ditës:

### **4. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Vitisë për vitin 2024**

**znj.Ibadete Hyseni, zyrtare për barazi gjinore:** Raporti pasqyron përmbledhjen e aktiviteteve apo ndërmarrjes së masave për evitimin e rrezikut që mund të cenoj integritetin e institucioneve komuanle. Ndër masat e ndërmarrja janë hartimi dhe aprovimi i planit zhvillimor komunal, formimi i grupeve punuese për hartimin e hartave zonale, plani i personalitetit, kodi i etikes i tërhequr për shkak se qeveria ka bërë kodin e etikës për shërbyesit civil, misionet për vlerësimet e aplikacioneve për subvencionim. Mos ta zgjas më shumë, materialin e keni marrë me kohë, i njëjti plan shkon në Agjensionin për Parandalimin e Korrupsionit, ku jemi të obligim të raportojmë çdo 6 muaj, nëse nuk raportojmë dënimi është 10 mijë euro për institucionin.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat. Pasi që nuk ka për debat e qes që të shkojë në kuvend. Pra me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim shkon në kuvend.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

### **5. Propozim vendim për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Këtë e shtinëm si pikë shtesë dhe e diskutojmë në kuvend. Pra, e qes në votim. A jeni që të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim shkonë në kuvend.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim planit për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Edhe këtë e shtinë si pikë shtesë dhe e diskutojmë në kuvend. Pra, e qes në votim. A jeni që të shkojë në kuvend? Pra me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim shkon në kuvend.Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:45

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Bekim Azizi**



Republika e Kosovë  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË · OPŠTINA VITINA

Pranuar-Prunjenë Me Data 15-01-2025			
Nr. i Organiut Org. Broj	Numri i Broj	Shtojca Ditë	Vlera Vrednost
02	035	02	28



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2, pika d e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenit 30, paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kryesuesi i Kuvendit propozon këtë:

### PROPOZIM VENDIM

**Për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2025**

#### Neni 1

Me këtë propozim Vendim, propozojmë që takimet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Vitisë, në vitin 2025, të mbahen si vijon:

Muaji	Takimet e Kuvendit të Komunës (Data)	Takimet e Komitetit për Politikë dhe Financa (Data)
Janar	30.01.2025	21.01.2025
Shkurt	28.02.2025	19.02.2025
Mars	28.03.2025	19.03.2025
Prill	30.04.2025	18.04.2025
Maj	29.05.2024	20.05.2025
Qershor	27.06.2025	18.06.2025
Korrik	31.07.2025	22.07.2025
Gusht	Pushim	Pushim
Shtator	30.09.2025	19.09.2025
Tetor	31.10.2025	22.10.2025
Nëntor	28.11.2025	29.11.2025
Dhjetor	29.12.2025	18.12.2025

#### Neni 2

Kuvendi sipas nevojës mbanë edhe mbledhje tjera të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

#### Neni 3

Seancat solemne të Kuvendit do të jenë, si në vijim :

- 17 shkurti – Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës;
- 5 Maj - Dita e Dëshmorëve të Komunës së Vitisë;
- 14 Qershor – Dita e Çlirimit të Komunës së Vitisë.

#### Neni 4

Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa do të mbahen njëherë në muaj, gjegjësisht 7 (shtatë) ditë para mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

#### Neni 5

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës  
**P.S. Orari i mbledhjeve mund të ndryshoj për arsye të ndryshme.**

Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi





REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE · OPSTINA VITINA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Pranuar - Pranimë më Datë... 10.01.2025			
Nr. i Organiut Org. Breg	Nomenklatura	Shprehje E Proq.	Vlera Vredhësi
02-035/02-			16

Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 35 të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferove me nr. 3346-1/2024, e datës 30.12.2024, nenin 50, shkronja i të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kryetari i komunës së Vitisë më datë 08.01.2025 i propozon për miratim Kuvendit të Komunës së Vitisë këtë:

## PROPOZIM VENDIM

**Për plotësimin-ndryshimin e vendimit Nr. 01-035/02-1356, të datës 29.11.2024, për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025**

### Neni 1

Kryetari i Komunës së Vitisë i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që ta bënë plotësimin-ndryshimin e vendimit Nr. 01-035/02-1356, të datës 29.11.2024, për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025.

### Neni 2

Bazuar në Kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferove me nr. 3346-1/2024, e datës 30.12.2024, plotësim-ndryshimi i vendimit të cekur në neni 1 të këtij propozim vendimit ka të bëjë tek preambula ku neni 9 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2, e datës 15 Shkurt 2018) fshihet dhe zëvendësohet dhe duhet të jetë neni 35 të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

### Neni 3

Te gjitha pjesë tjera të vendimit Nr. 01-035/02-1356, të datës 29.11.2024, për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025 mbeten në fuqi.


### Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

KRYETARI KOMUNËS  
Sokol Haliti







Emri i Dokumentit: 10.01.2025			
Numri i Dokumentit	Numri i Evidencës	Titulli i Dokumentit	Vlera e Dokumentit
02-035/02-15			

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008 dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.2, neni 8 paragrafi 1 pika 1.2, të Ligjit me nr. 06/L-092, për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja 1, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491, Kryetari i Komunës së Vitisë me datën 09.01.2025, bënë këtë :

### PROPOZIM VENDIM

**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit paraprak me nr. 01-035/02-1358 të datës 29.11.2024 për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit**

#### Neni 1

Me këtë propozim – vendim propozohet të behet ndryshimin dhe plotësimin i vendimit paraprak me Nr.01-035/02-1358 të datës 29.11.2024, për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes shprehjes së interesit, sipas kërkesës nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me shkresë Nr.020-315/5, të datës 23.12.2024.

#### Neni 2

Propozohet të ndryshohet preambula e vendimit me Nr.01-035/02-1358 të datës 29.11.2024 tek neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit me nr. 06/L-092, për dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës ndryshohet-plotësohet dhe duhet të jetë neni 6 paragrafi 1, pika 1.2, neni 8 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit me nr. 06/L-092 , për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës.

#### Neni 3

Neni 3 i Vendimit me Nr.01-035/02-1358 të datës 29.11.2024, ndryshohet-plotësohet prona e palujtshme komunale ipet në shfrytëzim afatgjatë deri në 20 vite përmes procedurës së shprehjes së interesit.

#### Neni 4

Pjesët tjera të vendimit me Nr.01-035/02-1358, të datës 29.11.2024, mbeten të pandryshuarar.

#### Neni 5

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:

Sokol Halilaj





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilbjenë Me Data 15.01.2023

Nr. Dokument Org. Broj	Niveli Broj	Shtetëre Perioq	Vlera Vrednost
01-060	01-39		



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

## **Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2024**

**Janar 2025**

**Nga: Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Tema: Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2024**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Kuvendit Komunal të Vitisë dhe komiteteve funksionale që janë të themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, për periudhën Janar- Dhjetor 2024.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, ka të themeluar edhe komitete obligative dhe komitetet joobligative.

Kuvendi Komunal i Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2024, ka realizuar po thuaja që 100% planin e punës se kuvendit për vitin 2024.

Kuvendi Komunal i Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2024, ka mbajtur gjithsej -XII- mbledhje të rregullta, -IV- mbledhje solemne dhe -I- mbledhje të jashtëzakonshme

Kuvendi ka miratuar gjithsej 64 vendime, 1 rregullore, ka shqyrtuar të gjitha kërkesat nga MAPL-ja.

Komiteti për Politik dhe Financa është komitet obligativ, i cili si çdo vit edhe në këtë vit është shumë aktiv, i cili për periudhën Janar-Dhjetor 2024 ka mbajtur -XII- mbledhje.

Komiteti për Komunitete gjithashtu është komitet obligativ, i cili këtë vit ka mbajtur -XI- mbledhje.

Përveç këtyre komiteteve, kemi të themeluar edhe komitete të tjera, si:

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale;
2. Komiteti për Shërbime Publike;
3. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
4. Komiteti për Liritë të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore;
5. Komiteti për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mirëmbajtjen të Mjedisit.

Pothuajse të gjitha komitetet e cekura me lartë joobligative, nuk kanë qen aktiv, sepse me Ligjin e Pagave nuk po lejohet pagesa e mëditjes.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prapjetim Me Dana ..15-01-2025..

Nr. Llogarit Orig. Baza	Niveli i	Shprehja Prillog	Vlera Vrednost
01-	016/01-		32



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

## Informatë mbi punën e Komitetit për komunitet të komunës se Vitisë për periudhën Janar - Dhjetor 2024

Janar 2025

**Nga: Kryesuesi i Komitetit për Komunitete**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Tema: Informatë mbi punën e komitetit për komunitete të komunës së Vitisë për periudhën Janar - Dhjetor 2024**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për komunitete të komunës së Vitisë për periudhën Janar- Dhjetor 2024, i cili komitete është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë.

Komitetit për Komunitete komunës së Vitisë është komitet obligativ, i cili si çdo vit edhe në këtë vit është shumë aktiv.

Komiteti për komunitetet e komunës së Vitisë për periudhën janar - dhjetor 2024 ka arritur një shkallë të lartë realizimi të planit të punës së komitetit, afërsisht 100% realizim të planit të punës për vitin 2024.

Komitetit për Komunitete i komunës së Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2024, ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje të rregullta ku ka shqyrtuar tema të ndryshme dhe ka dalur me kërkesa konkrete dhe rekomandime për zyrën e kryetarit të komunës së Vitisë dhe drejtorive përkatëse komunale.

Numër i madh i rekomandimeve që janë miratuar në mbledhjet e Komitetit për Komunitete janë realizuar nga organet kompetente të komunës, besoj se do të realizohen edhe të tjerat gjatë këtij viti.

Komitetit për Komunitete i komunës së Vitisë ka miratuar edhe planin e punës se këtij komiteti për vitin 2025 të cilin plan është miratuar në Kuvendin Komunal të Vitisë

**Me datën: 15.01.2025**

**Kryesuesi i Komitetit  
Srdjan Djuric**





REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilbeto Me Dana 10-12-2024			
Nr. i Organiut Org. Broj	Numri Broj	Shtypje i Prilbjes	Vlera Vrednost
02-	016/01-		9608



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Vitina

## INFORMATË PËR ZBATIMIN E PLANIT TË KKSBS-së PËR VITIN 2024

Viti, Dhjetor 2024

Bazuar në Planin e Punës së KKSB-së për vitin 2024, ku kanë qenë të parapara një sërë objektiva dhe aktivitete për realizimin e këtyre objektivave, KKSB ka kryer këto aktivitete:

- Janë mbajtur 4 takime të KKSB-së, ku në këto takime përveç raportimit të rregullt të gjendjes së sigurisë në Komunë e Vitisë, nga Policia e Kosovës, janë shtjelluar tema të ndryshme rreth çështjes së sigurisë publike të qytetarëve.
- Në lokalitete të ndryshme të Komunës së Vitisë është rregulluar sinjalistika horizontale dhe vertikale në komunikacion
- Janë rregulluar trotuare në shumë zona të komunës
- Është rregulluar ndriqimi publik në disa zona të Komunës
- Policia e Kosovës, bazuar në Planin e KKSB-së dhe në planet e saja operationale ka kryer një sërë aktivitetesh të cilat janë realizuar në komunitet dhe me nxënës në shkolla e të cilat janë:

Organizimi i ligjëratëve në disa shkolla të Komunës së Vitisë me këto tema: Parandalimi i trafikimit me njerëz, Parandalimi i dhunës në familje, lajmet e rreme ( Fake News), parandalimi i përdorimit të narkotikëve, keqpërdorimi i rrjeteve sociale (krimet kibernetike), ku këto aktivitete janë realizuar edhe nga QPS, dhe psikologë shkollorë

- Janë formuar ekipet e nxënësve për siguri në shkolla, të cilat do të identifikojnë problemet e nxënësve që cenojnë sigurinë e nxënësve në shkollë dhe do të propozojnë masa për parandalimin dhe luftimin e tyre
- Është funksionalizuar Këshilli Komunal për Parandalimin e Dukurive Negative nga të rinjtë, i cili këshill është duke hartuar propozim masa të reja në parandalimin e këtyre dukurive
- Komuna në bashkëpunim me forumet e sigurisë siç janë Policia dhe EVSB ka shënuar javën për të drejtat e viktimave të krimit, ku janë shpërndarë posterë me moton “ Thyeje heshtjen, raporto viktimat e krimit”
- Komuna e Vitisë, ka shpallur vitin 2024 vit të mbrojtjes së pyjeve, ku në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe sektorin e pyjeve janë vendosur pikat statike për kontrollimin e pyjeve në mënyrë të pengimit të dëmtimit të pyjeve nga persona të papërgjegjshëm si dhe ka shpërndarë posterë me mesazhe për mbrojtjen e pyjeve
- Policia e Kosovës vazhdimisht ka bërë patrullimin e rrugëve frekuentive me nxënës të shkollave si dhe gjatë orarit të vajtjes së tyre në shkollë dhe anasjelltas

- Mbajtja e takimeve të rregullta ndër institucionale dhe ndër komunale : KKSB-EVSB-KLSB, të tjerë
- Trajnimi i vazhdueshëm i zyrtarve policor për konceptin e policimit në bashkësi
- Policia e Kosovës përmes planeve operative dhe të vazhdueshme ka ushtruar kontrollë të trafikut rrugor për të zvogluar aksidentet
- Zyra përt Riatdhesim ka ofruar vazhdimisht shërbime dhe udhëzime për personat e riatdhesuar
- Policia e Kosovës në vazhdimësi ka zbatuar Planin operativ për siguri në shkolla, ku rregullisht ka monitoruar sigurinë në shkolla
- Policia e Kosovës ka bërë rregullisht patrullimin e rrugëve gjatë fushatës së korrje shirjeve përgjatë muajit Korrik
- Policia e Kosovës ka bërë patrullimin e rregullt në trafik gjatë qëndrimit të mërgimëtarve në vendlindjet e tyre ( përgjatë muajit Korrik – Gusht)
- Me datë 18 Tetor është bërë hapja e fushatës kundër trafikimit me qenie njerëzore me moton “ Mos Hesht”, ku për gjatë këtij muaji janë mbajtur aktivitete të shumta me nxënës në shkollat e mesme të larta si dhe në ato të mesme të ulëta
- Me datë 25 Nëntor është bërë hapja e fushatës për parandalimin e dhunës në familje me moton “ Sot dhe çdo ditë tjetër” e cila është shënuar me aktivitete të shumta në shkolla dhe komunitet dhe janë shpërndarë posterë me mesazhe sensibilizuese për parandalim dhe raportim të rasteve viktime të dhunës si dhe me datë 10 dhjetor është bërë mbyllja e kësaj fushate me aktivitete të shumta në shkolla në shënim të ditës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut 10 Dhjetorit.
- Drejtorja e Arsimit në bashkëpunim me Njësia e sektorit dhe komunitetit në Polici, në vazhdimësi ka mbajtur takime me drejtorë të shkollave të komunës së Vitise dhe njëkohësisht me këshillin e prindërve në bashkërendim të aktivitetëve të ndryshme në luftimin e dukurive negative në shkolla.

Dhjetor 2024, Viti

